

ARTUR LAMAJ

**MBI VARIACIONIN LEKSIKOR NË VEPRËN “ATLASI
DIALEKTOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE”**

Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe është vepër madhore e gjuhësisë sonë. Në këtë kod ku zënë vend parësor pamjet e të folmeve e të ndarjeve më të mëdha dialektore shqiptare, ndeshemi me harta, simbole e diagrama që hapin udhë edhe për perceptimin e larmisë ndërshtesore, për ndarjen krahinore e administrative, për “rrënjët” historike të shqiptarëve.

Duke kundruar vëmendshëm materialin që ndeshim në këtë vepër të vëllimshme, vërejmë se të dhënat gjuhësore e jogjuhësore janë mundësuar nga bashkëpunimi i specialistëve të gjuhës me subjekte folësish që shfaqen në intervista, në bisedat e përditshme sipas raportit që kanë me gjuhën letrare shqipe (standardin), sipas statusit që u mundësohet në praktikën gjuhësore krahinore.

Së pari, është e rëndësishme të pohojmë se kjo vepër, projekt i strategjisë së shkencës shqiptare për hetimin e përgjithshëm të dialekteve, u hartua prej dialektologëve shqiptarë Jorgji Gjinari, Bahri Beci, Gjovalin Shkurtaj, Xheladin Gosturani e bashkëpunëtorëve të tyre Anastas Dodi e Menella Totoni. Zgjedhja e kujdesshme e informatorëve, akribia shkencore, vizioni, puna e palodhur për disa dekada e këtyre studiueseve të të folmeve shqiptare, mundësuan mbledhjen e regjistrimin e materialeve të shumta në terren, zbulimin e dukurive dialektore fare të panjohura, zgjerimin e përditësimit e mozaikut të kësaj vepre themelore përgjithësuese të dialektologjisë shqiptare, që për studimin e dialekteve përdori *hartografimin, si metodë e gjeografisë gjuhësore*.

Studimi i të folmeve shqiptare sipas risive që mundësonte gjeolinguistika, u mbështetet në disa konceptime të dialektologëve evropianë. Në studimet e fundshekullit XIX dhe fillimet e shekullit XX gjeografia gjuhësore iu kundërvu gramatikanëve të rinj që i perceptonin dialektet lokale “*si forma gjuhësore të prishura e të zvetnuara*”, gjeti hapësira përqsasë tek gramatika krahasuese, mbështeti mbijetesën e dialekteve dhe veçoritë e tyre dalluese¹. Në këtë hulli, por ndryshe nga disa atlas gjuhësorë evropianë, në ADGjSh faktet dialektore konkrete ”përfaqësojnë vijën e kryqëzimit të shumë

¹ Dubois, J. - Giacomo, M. - Marcellesi, Ch. *Dictionnaire de linguistique*, f. 230, Paris, 1973.

dukurive dialektore cilësorisht të ndryshme, të përgjithshme dhe të pjeshme, fonetike, morfologjike, leksikore e sintaksore”.²

Leximi dhe shkodimi i ADGjSh -së *si një entitet dialektor shumëvlerësh*, mundësohet falë vëzhgimeve përshkruese, falë pyetësorit që përmban nocionet për të cilat u drejtohesh subjekteve të pyetura, informacioneve që sjellin faktet e veçanta (sintagmat, trajtat dhe fjalët e regjistruara), dukuritë dialektore, simbolet, izoglosat, hartat jogjuhësore e gjuhësore, të cilat zotërojnë një përmasë gjeografike. Në hapësirat e këtij kodi ndeshim tiparet dalluese që i përkasin *sistemit fonetik*, d.m.th tiparet që i ndajnë dialektet e të folmet sipas pranisë a mungesës së trajtave të fonemave zanore gojore e hundore, të fonemave e grupfonemave bashkëtingëllore; sipas këmbimeve e varianteve fonetike, sipas dikotomisë së grupzanoreve nistore etj; *larminë morfologjike*, d.m.th varietete që lidhen me mbaresat e gjinisë, numrit, trajtës tek emrat, me mbaresat vetore dhe strukturën foljore, *distribucionin sintaksor* që ideohet sipas formave foljore në funksione e marrëdhënie të caktuara apo falë parafjalëve që merr emri në marrëdhënie vendore, veprimi, shkaku etj.; *variacionin leksikor*, d.m.th fjalë, trajta e tipa fjalësh me ”fytyrë” dialektore e krahinore.

ADGjSh-ja sjell materiale të shumta për variacionin leksikor. Hartat përgjithësuese dhe ato që paraqesin fjalë të veçanta, flasin për kujdesin që kanë treguar autorët e kësaj vepre për thesarin leksikor që mbartin të folmet shqiptare. Në fakt, fjala shqipe është një krijesë e popullit me vlera shumëpërmasore. Nëse e vështrojmë lindjen e përdorimin e saj në ligjërimin zyrtar a dialektor, vërejmë se folësi popullor ka vënë në të dorën dhe dashurinë e vet për ta krijuar; shkrimtari falë talentit, organizimit metaforik e metrik, ka synuar lëmimin e zbulimin e një forcë më të madhe shprehëse; gjuhëtari duke përdorur pyetësorin, anketat, analizën, ka mëtuar gjurmimin e zbulimin e vlerave. Ajo është perceptuar si pika thelbësore e një netuorku gjuhësor. Përmbajtja dhe forma i ka nxitur studiuesit ta trajtojnë fjalën si shenjë gjuhësore, si njësi të sistemit gjuhësor, por sidomos si njësi të nënsistemit leksikor. Tek fjala janë hulumtuar etimologjia, transformimet fonetike, familja leksiko - semantike, sinonimet, antonimet, variacioni semantik, hiperonimet, strukturimi i saj në lokucione e proverba etj.

Kur flasim për variacionin leksikor, kemi parasysh *krahinorizmat dhe dialektalizmat*. Këto njësi leksikore, kuptimore e frazeologjike të krijuara në një truall dialektor, janë njësi të pandashme nga e tëra, gjuha shqipe, ashtu si

² Domi, M. Kriteret e përgjithshme të Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, në ”*Dialektologjia shqiptare*”, Tiranë, VI, 1990, f. 9.

vetë trualli krahinor i së folmes është pjesë e pandarë e truallit të mbarë shqipes³. Për përcaktimin e këtyre nocioneve, kemi marrë parasysh kriteret e parimet e përgjithshme të ADGjSh- së, të cilat si pikënisje për krahasim marrin "kundërvënien e dialekteve me njëri - tjetrin, ose me gjuhën letrare kombëtare shqipe"⁴, si edhe klasifikimet e leksikologëve të zëshëm shqiptarë.⁵

Përkushtimi i disa studiueseve për studimin e dialekteve i ka dhënë fytyrë një vepre me pasuri e larmi leksikore që falë anketave ka gjurmuar të folmen e lokaliteteve. Duke e lexuar atë vëmendshëm, pajtohesh me vlerësimin e studiuesit Goose Andre se "atlase të tilla, *edhe pse nuk mund të kenë pasurinë leksikore të një fjalori...*", përmbajnë koncepte e realie që gjallojnë sistematikisht në të gjithë territorin shqiptar, "duke u bërë më sintetike e më shprehëse sesa një vepër leksikografike"⁶. Në këtë vepër (ADGjSh) *që ka 1065 faqe, 644 harta, prej të cilave, 361 në vëllimin e parë dhe 273 në vëllimin e dytë*, "paraqiten njëherësh të gjitha të folmet e shqipes me nënsistemet e tyre gjuhësore",⁷ bëhet i mundur vështrimi i përputhjes së tyre me sistemin parësor të shqipes. Njësinë e makrosistemit dhe bashkëvajtjen e tij me ndryshimet, larminë dialektore e krahinore, mund ta perceptojmë më mirë, falë të dhënave leksikore që sjellin hartat vëllimit e dytë e disa studime për të folme, grup të folmesh, nëndialektet shqiptare.

Sipas variacionit të përdorimit dhe *dikotomisë njësi – larmi*, mund të bëjmë klasifikimin e mëposhtëm:

a. Fjalë të makrosistemit, gjuhës së përbashkët shqipe që gjallojnë pa variante në të dy dialektet: *dash, drapër, dele, dhi, gjizë, motër, mushkë, viç, korr (grurë)* etj.

b. Fjalë dhe sintagma me shtrije mbidialektore: *afrohem, bërthamë, derr, koj(fëmijën), largohem, mëllenjë, misër, patate, përzë, pjergull, qepujkë, qen, rurëz, sorrë, ulem, zbres* etj.

³ Thomai, J. *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f. 239.

⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Napoli, 2007, f. 17.

⁵ Shih përkufizimin e termave: **krahinorizëm** si fjalë "që gjendet në një të folme, ose në të folmet vetëm të një krahine, por që nuk e ka gjuha letrare" apo **dialektalizëm** që, në kuptimin më të gjerë, merret "çdo fjalë e një dialekti përballë gjuhës letrare" të perceptuara nga akad. Jani Thomai në punimin « *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme* », Tiranë, 2001, f. 239.

⁶ Goose Andre, *Histoire cavaliere de la dialectologie wallonne*, në "Revue generale", maj 1998, f. 72.

⁷ Shkurtaç, Gj. Vendi i të folmeve arbëreshe të Italisë në izoglosat të ADGjSh –së, në « *Studime albanologjike* », Tiranë, 1997, 1, f. 104.

c. Fjalë që në të gjitha raportet e kontekstet e përdorimit, janë të dialektit të Veriut, *gegërishtes*: *axhë, bishtalec, bizë, cur, dac, grosh, kërtollë, kompir, prezore, tamël, tatë, tëlyen, rej, skile, tinëz* etj.

d. Fjalë që në të gjitha raportet e kontekstet e përdorimit, janë të dialektit të Jugut, *toskërishtes*: *katarosh, kukumjaçkë, lëpushkë, milore, ngas, nuselalë, shtjerrë, strofull, tartabiqe, zagal* etj.

Gjuha dialektore është vënë vijimisht *përballë tërheqjeve të larmishme*: traditës, kulturës stërgjyshore, narracionit dhe mitologjive të territorit, larmisë së sferave shoqërore të folësve, migrameve të tyre ndërkrainore e në metropolin shqiptar, “shndërrimit të regjistrit gjuhësor deri në ndërrim të plotë”⁸, ndikimit prej gjuhës letrare, globalizimit e zhvendosjes së niveleve të komunikimit. Sipas këtij vështrimi, “leksikalizmat” dialektorë mund të grupohen:

a. Fjalë e sintagma me burim dialektor që janë shtrirë në përdorim më të gjerë, duke i kapërcyer kufijtë e dialektit mëmë: *aradhik, brumës* (gjalpë), *bëj*(ndërtoj) *shtëpi, cergë, çun, çup, del* (dielli), *kulm, shkop* (filiç), *trangull, vocërrak* etj.

b. Fjalë e sintagma që gjallojnë në të folme të veçanta: *bërkoc* “derrkuc” në Durrës e Krujë, *binish* “stërdhëmb” në Bregun e Matit, *bishtafurk* “bukël” në Tiranë, *cingris* “ngacmoj” në të folmen e Gjirokastrës e rrethinave të saj, *çapërko:s* “bretkosë”, në Malësinë e Madhe e Dukagjin, *fije* “hala gruri” në Kavajë, *krep* “vesh rrushi” në të folmen e Dumresë, *pulkare* “shushunjë” në Mirditë, *qep ujse* “qepujkë” në Poshnjë të Beratit, *shtup* “lëvore” në Mirditë e Peshkopi, *zjamez* “xixëllonjë” në Buz të Tepelenës, *vlla xhaki* “vëllam” në të folmen e Gjakovës etj.

c. Fjalë dialektore që e kalojnë provën e vlerës (normës) së gjuhës letrare: *bishtajë, përvjel, gëmushë, hulli, ngastër* etj.

Repertori gjuhësor dialektor, i sendërtuar në ADGjSh falë hartave gjuhësore e simboleve të larmishme, na çel shtegun për të studiuar edhe fjalët me kuptim të njëjtë e afërt (*sinonimet*), si një grup paradigmatic “që shërben për të shprehur me saktësi idetë”⁹ e folësit; ta gjurmojmë *sinoniminë leksikore* si mundësi nxitëse gjuhësore për kapërcimin e pragut të së folmes vendore; si mënyrë shënimi e përpiktë “për shprehjen e një nocioni ose saktësimin e

⁸ Thomai, J. *vep. cit.* 2001, 83.

⁹ Islamaj, Sh. Roli i sinonimisë në pasurimin e gjuhës, në “*Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*”, Tiranë, 1989, III, f. 359.

kuptimit të tij”¹⁰. Sipas këtij vështrimi, d.m.th sipas raportit që krijohet mes shenjës dhe kuptimit, duke e kërkuar “bazën racionale të sinonimisë tek pluraliteti i mjeteve shprehëse”¹¹, mund të bëjmë klasifikimin e mëposhtëm:

a. Fjalë dialektore që krijojnë çifte sinonimike me fjalët e makrosistemit leksikor të *shqipes*: *bobël – kërmill, gërshet – bisht, verigë – vesh, kockë – rasht, plagosem – varohem, qukapik – pikth, ricër – këpushë, rosë – rikë, shelege – rurëz, varem- zbres* etj.

b. Fjalë të folmesh të veçanta që krijojnë çifte sinonimike me fjalët e të folmeve të tjera: *binjak – bliznjak, fole – strofkë, godit – qes (me pushkë), këndez – kokosh, kokole – çapele, luj – ngas, mizë dheu – mizë përdhese, shot-gu:s, vëlla – burazer* etj.

Pasuria leksikore dialektore mund të studiohet edhe nga *pikëpamja leksiko-gramatikore*. Ky fond leksikor i vëllimshëm përbëhet në pjesën më të madhe prej fjalëve shënuese konkrete. Nga një vështrim i vëmendshëm i ADGjSh-së, vërejmë se edhe përpjesëtimi midis fjalëve shënuese nuk është i njëjtë. Vendin kryesor e zënë emrat e foljet, kurse ndajfolje ka më pak. Sipas tipave fjalëformues, janë më të shumta fjalët dialektore të prejardhura me prapashtesat *-ak*: *farak, vejak, veshak, -an*: *bacan, dacokan, maçokan, vejan, verdhan*; *-(a)nik*: *faranik, lisnik*; *-icë*: *galicë, gërgëlicë, loricë, murrice*; *-kë*: *guguçkë, kulaçkë, pulkë*; *-ok*: *bardhok, daçok, maçok, misrok, viçok*; *-ul(e)*: *kashtule, veshul*, por nuk mungojnë edhe leksemat dialektore të prejardhura me prapashtesa të tjera.

Pasuria leksikore e të folmeve dhe dialekteve të *shqipes* përmban dukshëm edhe tipin e fjalëformimit me kompozim, si: *babzot, babxhyshe, bukëdjathëza (milingona), buzëzi (grethi) mëmëzonjë, nanbabe, nanmir, nanplak, nëndajko, tatmadh, tatmir* etj. Fjalët dialektore të thjeshta dhe ato të formuara me rrugë të tjera janë më të pakta. Në repertorin e emërtimeve dialektore ndonjëherë kompozitat zëvendësohen me sintagma emërore, si: *baba i madh, tata i madh*, por larushia dialektore shpërfaqet edhe falë sintagma të tjera (emërore e foljore): *gjembat e grurit (halat), grue e lodhun (lehona), lorza e keqe (laraskë), od bylmeti (qilar), mizë përdhese – mizë trolli (milingona); qep ujse (qepujkë), (qes – krej) jashtë (përzë)* etj.

Kur flasim për tipologjinë funksionaliste të leksikut dialektor, nuk mund të anashkalojmë *fjalët e huaja*, të marra në kontaktet historike a takimet

¹⁰ Hidi, A. Sinonimet dialektore dhe pasurimi i leksikut të gjuhës letrare shqipe, në “*Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*”, Tiranë, 1989, III, f. 377.

¹¹ Bulgar, Ch. *Dictionar de sinonime*, Bucuresti, 1972, f. 2.

ndërkufitare të gjuhës shqipe me gjuhët sllave, turqishten, greqishten, italishten. Ato janë vlerësuar si “shenja dhe gjurmë që ka lënë afërsia e shkëmbimet e ndryshme të shqiptarëve me popujt që i kanë folur ato gjuhë”¹². Shqyrtimi i elementeve leksikore të huazuara paraqet vështirësitë e veta, por në gjuhësinë tonë, përmes “kërkimeve të kombinuara, të cilat mbajnë parasysh të dhënat gjuhësore dhe jogjuhësore”¹³, janë bërë vlerësime e klasifikime për këtë shtresë leksikore. Studiuesit shqiptarë që i janë qasur kësaj shtrese, me të drejtë kanë pohuar se shumë huazime leksikore “kanë mbetur në të folmet shqiptare si historizma, arkaizma dhe krahinorizma”¹⁴. Duke kundruar vëmendshëm përhapjen e këtyre elementeve leksikore në arealet dialektore të truallit shqiptar, vërejmë se sllavizmat, greqizmat janë kryesisht krahinore, kurse turqizmat e kapërcejnë këtë prag, ato janë edhe fjalë dialektore.

Sllavizmat krahinorë i ndeshim në dy areale kryesore. Areali i parë i ndikimit sllav përfshin të *folmet serbe të Malit të zi*, në të cilin janë zbuluar e hulumtuar rreth 100 sllavizma specifike¹⁵, si: *belinë, duhi, poronik probatin, prezore, strupë* etj., kurse areali i dytë i ndikimit është ai *bullgaro – maqedonas* që përfshin disa rajone: Gegërinë e mesme, Gegërinë jugore, brezin e të folmeve kalimtare, Toskërinë veriore dhe Toskërinë jugore.¹⁶ Nëse i vështrojmë sllavizmat sipas shtrirjes e shkallës së ngulitjes, vërejmë se ato përdoren në situata ligjërimore të kufizuara, sidomos nga brezi i vjetër, i cili ka realizuar kontaktet, mesazhet e bashkëbisedimet e veta, duke shtënë në repertorin leksikor fjalë maqedono - bullgare, si: *branë, bodec, drugë, galinë, gllanik, gallof, grabujë, kopan, kotele, lesë, lisnik, zhabë* etj.

Ndikimet e sllavishtes ndjehen edhe në *sferën e fjalëformimit*. Falë produktivitetit të prapashtesave me funksione dimunitive, hipokoristike, emërtuese¹⁷ **-kë, -icë, -ovinë**, janë formuar në Toksërishten veriore trajtëforma dhe fjalë me kuptime të reja: *bimkë* “bima e misrit që *tharret* gjatë prashitjes”, *gockë* “bërthamë me guackë të fortë” *kallëpkë* “kalli misri”, *katinarkë* “dryn”, *miskë* “pulë deti”, *shqerkë; burbulicë* “insekt me emrin pashkëz, *gushtericë, steranik, dhallanik, petanik, vezanik, djalovinë* “cunak”, *gurovinë* “tokë me gurë etj.

¹² Shkurtaç, Gj. *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003, f. 121.

¹³ Jorgaqi, K. Sprovë për identifikimin e huazimeve leksikore italiane në shqipen e sotme, në «*Studime filologjike*, 1992, 1-4, f. 55-56.

¹⁴ Koastallari, A. *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Tiranë, 1984, f. 35.

¹⁵ Shih Thomai, J. *vep. cit.* 2001, f. 41.

¹⁶ Shih Thomai, J. *vep. cit.* 2001, po aty.

¹⁷ Gjinari, J. Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë jugore, në «*Studime filologjike*», 1966, 2, f. 163.

Leximi i ADGjSh- së me prirjen për të përcaktuar shtrirjen, statusin dhe përshtatjen e huazimeve leksikore nga greqishtja, na përball me arealet e skajeve Jugore e Juglindore, sidomos me të folmen e Çamërishtes, por edhe me diasporën e arbëreshëve të Italisë. Nga materiali i vjelë në këtë atlas, vërejmë greqizma krahinorë të asimiluar e të paasimiluar: *argali* “tezgjah”, *cangadhe* “dele, dhi”, *cangar* “këpucar”, *cimbidhe* “mashë”, *dhiozmë*, *dhokan*, *dhrihal* “cfurk”, *gastra* “saç”, *nome* “vath dhënësh”, *raht* “rrobaqepës” etj.

Turqizmat, si një shtresë leksikore që shpërfaq marrëdhëniet historike mes shqipes e turqishtes¹⁸, janë kryesisht me shtrirje dialektore. Ato kanë depërtuar në gjuhën tonë jo nëpërmjet të folmesh kufitare, por falë kontakteve më të gjera gjatë pushtimit pesëshekullor. Fusha tematike e këtyre fjalëve të huazuara lidhet me zejtarinë, veshjen, me mjetet shtëpiake prodhimet bujqësore e blegtorale: *aksham*, *çatall*, *çini*, *ferexhe*, *ibrik*, *izbë* “qilar”, *janxhik* “shakull”, *kajmak* “ajkë”, *masur*, *saxhak* “këmbje”, *setër* “xhaketë”, *sojak* “brisk, biçak” etj.

Variacioni leksikor mund të hulumtohet e studiohet sipas prerjeve e rrafshëve të ndryshme gjuhësore. Për të bërë një analizë analitike, duhet të depërtojmë më thellë në përmbajtjen e njësisve leksikore e dialektore. Është e rëndësishme të pohojmë se sot dija semantike ka dhënë përgjigje shkencore për disa dukuri, klasa dhe kategori semantike. Analiza semantike e lëndës leksikore që shfaqet në ADGjSh, na lejon të dallojmë grupe tematike a fusha semantike që lidhen:

a. me terminologjinë që përdor njeriu për *qiellin dhe dukuritë e natyrës*: **vesë** “*pikla uji që formohen gjatë natës a në mëngjes herët mbi bar, mbi gjethë*”, akuatinë, bry:m, lagshta, ro:s, ruxhadën, verdha.

b. me mundësitë e tij përzgjedhëse për emërtimin e *bagëtive të imëta e të trasha* sipas tipareve dalluese të jashtme (ngjyrës, trajtës së trupit dhe pjesëve të tij) e vetive të tjera: **ftujak** “*kec në deri në dy vjeç*”, batuk, çerveatës, cimbareli, karçin, kec mashkëll, pjellak, përçok, protojen, skopak, trabokull, vjetun, vetul; **mëshjtjerrë** “*viçe afërsisht mbi tetëmbëdhjetë muaj, që ende s’ka pjellë*”, mëzatore, mëzore, viçe, jenkë.

c. Me kodimin që përdoret për emërtimet e termave të botës *bimore e drusore*: **dorëz**, *demek*, *demet*, *dënzhëz*, *duaj*, *fashun*, *kashtor*, *kacule*, *kacup*, *ka:p*, *kapicë*, *kapule*, *kunorë*, *lidhje*, *nuskë*, *polloge*, *tropil*, *tufë*, *vandak*; **trung**: *kurm*, *kërcull*, *kërcur*, *kundur*, *kucur*, *pedhar*, *pedhikum*, *stup*, *trup*, *tra:sha* etj.

¹⁸ Kostallari, A. Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII, në “*Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*”, Tiranë, 1989, III, f. 95.

d. me emërtimet që shënojnë mjetet dhe përdorëset e shtëpisë: **mashë**, *bigë, cimbidh, mashi:c, mashake, molletë, penxë, pickaroh, tano:j* etj.

Analiza semantike na mundëson edhe për të njohur *vëllimin e shpërndarjen kuptimore* të fjalëve krahinore. Në hapësirat e ADGjSh -së ndeshim fjalë që janë rishënuar a riformuar ndryshe fonetiki në rrjedhën e kohës, ndeshim kuptime krahinore që e zgjerojnë strukturën e tyre. Njohja më e thellë e anëve të veçanta të sendeve dhe frymorëve, afria, “migrimi” kuptimor, “*fluturimi gjithnji e gojë më gojë i fjalëve shqipe, gjatë shekujve,*”¹⁹ kontekstet e përdorimit, i ka dhënë dorë një karakterizimi të larmishëm metaforik. Sipas këtij vështrimi, mbështetur në treguesit më të spikatur të realieve të botës bimore e shtazore që ka marrë parasysh folësi krahinor, mund të bëjmë klasifikimin e mëposhtëm:

a. fjalë që formësohen duke mbështetur në treguesit e tipareve të realies: *briska* “dele, dhi me brirë të vegjël”, *gurgule* “kukuvajkë”, *jeshil* “kastravec”, *knues* “këndez”, *pijavec* “shushunjë”, *provokaç* “akrep”, *trasha* “trung” etj.

b. fjalë që formësohen duke mbështetur në treguesit e mjedisit ku ndodhet a ku rritet realia: *dheule* “milingonë”, *feraçk* “sorrë”, *grykëza, kreja* “ajkë”, përdhjese “shushunjë” etj.

c. fjalë që formësohen duke mbështetur në tregues të tjerë të realies” e mjedisit: *misrok* “gjel deti”, *mustaqe* “halat e grurit”, *sarandisë* “lehonë” etj.

Nga sa parashtruam, mund të përfundojmë se në këtë kod hapen udhë për perceptimin e klasifikimin e varieteteve leksikore sipas përdorimit, dikotomisë njësi – larmi, shndërrimit të regjistrit gjuhësor, ndikimit prej gjuhës letrare, globalizimit e zhvendosjes së niveleve të komunikimit. Analiza leksikore sendërtohet e plotësohet edhe falë njohjes së vëllimit, shpërndarjes kuptimore të fjalëve krahinore, *grupeve tematike e fushave semantike*. Hapësirat e ADGjSh - së janë areale gjithëpërfshirëse për mendjen e gjuhëtarit, fantazinë e shkrimtarit, për analizat shoqërore e shkencore të historianit e gjeografit.

¹⁹ Koliqi, E. *Bukuria e gjuhës shqipe*, cituar sipas Gjovalin Shkurtajt në “*Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*”, f. 168.

SUMMARY**LEXICAL VARIATIONS IN THE ATLAS OF ALBANIAN LANGUAGE
DIALECTS**

The reading and decoding of the Atlas of albanian language dialects, as an *entity with a multiplicity of values*, is made possible due to descriptive observation, due to the survey including the right notions addressed to all the subjects polled, due to the information provided by separate facts (phrases, forms and words recorded), dialect phenomena, isoglosses and linguistic and non-linguistic maps of geographical dimensions. Throughout this code we come across distinguishing features concerning the *phonetic system*, *morphological diversity*, *syntactic distribution*, *lexical variation* i.e. separate words, word forms and word types with regional and dialectical variation.

Form and content has urged scientists to treat the word as a linguistic sign, as a unit of the linguistic system, but above all **as a unit of lexical sub-systems**. The word is the object of analysis concerning etymology, phonetic transformations, lexical and semantic family, synonyms, antonyms, semantic variation, hiperonymy as well as its structuring in sayings and proverbs.

When talking about lexical variation we mean regionalism and dialecticisms. The definition of these notions is based on the general criteria and principles of the Atlas, which consider the contraposition of the dialects to one another or to the literary national Albanian language, as well as the classifications of distinguished Albanian lexicologists, to be the stepping stone for the comparison.

The unit of the macro system and its concurrence with the changes, the regional and dialectical diversity can be better perceived due to the lexical data found in the maps of the second volume as well as some research carried out on some kinds of speeches, groups of speeches i.e. Albanian sub-dialects. According to the usage variation and dichotomy between unit and variegation, we could provide the following classification:

- a.** *words of the macro system*; common Albanian language *existing* without variants in dialects, words and syntagmata of a range beyond the dialects.
- b.** *words that belong to the Northern dialect (Gegërisht)* regardless of the context.
- c.** *words that belong to the Southern dialect (Toskërisht)* regardless of the context.

The linguistic dialectal repertoire enables us to study lexical synonymy as an added incentive to go beyond the regional language. According to this point of view we distinguish:

a. Dialect words that form synonymic pairs with words of the Albanian lexical macro system: e.g. bobël- kërmill, gërshet-bisht.

b. words from one type of speech forming synonymic pairs with words from another type: e.g. binjak-bliznjak, fole - strofkë etc.

The lexical dialectal richness can be studied even from the lexical-grammatical point of view. This vast lexical fund consists mostly **of significant words denoting concrete objects**. Nevertheless, the proportion of these significant words is not the same; verbs and nouns come first, thus outnumbering the adverbs.

When talking about the functional typology of the dialectal lexicon, one cannot forget to mention the borrowings from other languages either because of historic events or neighborly interactions of the Albanian language with the Slavic, Turkish, Greek and Italian. The analysis of the lexical elements borrowed from these languages has its own difficulties, yet research and classification for this lexical layer is made possible in our linguistics on the basis of "Combined research taking into consideration linguistic and non-linguistic data". By means of a careful observation of the distribution of these lexical elements in the realm of the Albanian language dialects, it is noticed that Slavic and Greek borrowings are mainly regional, whereas those borrowed from Turkish go beyond that limitation and are considered as words of dialect.

Semantic analysis of the lexical material in the atlas of Albanian language dialects allows us to distinguish *thematic groups or semantic fields as well as the semantic volume and distribution of regional words*. In the Atlas we encounter words that, in the course of time, have undergone phonetic changes or have developed regional meanings that have broadened their structure.